

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE RROBA PUNE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

18100000-0

18235400-9

18800000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

1 990 625(nje milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzetë e pesë) **Lekë pa TVSH.** Bazuar në nenin 76 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik” e ndryshuar, në zbatim të urdhërit të titullarit, për ngritjen e komisionit për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës sipas specifikimeve teknike për këtë procedurë prokurimi, komisioni bazuar në VKM 285 datë 19.05.2021, është bazuar në ne cmimet e procedurave te ngjashme te zhvilluara nga AK në vitin e kaluar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim për procedurën, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Në zbatim të nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020) është 2% e fondit limit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata ".*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 30 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetare, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës procedurë e hapur të thjeshtuar, edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin e fundit (duke përfshirë edhe këstet e maturuara për vitin 2026, duke pasur në vëmendje parashikimet e ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetqeverisjes vendore), për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Kapaciteti Teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për kontrata të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh*

përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë nëpërmjet së cilës merr përsipër dorëzimin e mallit objekt prokurimi në destinacionin e kërkuar nga AK.

Argumentimi: *Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se marrin përsipër levrimin e objekt prokurimi sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktor.*

Deklarata i shërben AK si një instrument sigurie që minimizon rrezikun e mos levrimit të mallit sipas kërkesave të AK, rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, krijon bazë për monitorim dhe zbatim korrekt të kontratës.

2.3.3 Në menyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt ME NUMRAT RENDOR SI ME POSHTE(REFEROJU SHTOJCËS NR. 7 NË DST), në datën dhe orën e hapjes së procedurës.

1, 2, 3, 4, 5, 6, 10, 11

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike dhe përshatshmërinë që ato duhet të kenë.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor për cakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces.*

SPECIFIKIME TEKNIKE

Të gjithë artikujt objekt prokurimi duhet të jenë të rinj, të papërdorur, me cilësi të parë dhe në përputhje me standardet për sigurinë dhe mbrojtjen në punë.

Materialet duhet të jenë rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe përdorimit intensiv në terren.

Xhaketë Pune

- Material rezistent ndaj konsumit dhe lagështirës.
- Përbërja e materialit: pambuk/poliester ose ekuivalent.
- Me mëngë të gjata dhe mbyllje me zinxhir ose kopsa.
- Të ketë elementë reflektues për dukshmëri në terren.
- Me xhepa funksionalë të jashtëm dhe të brendshëm.
- Ngjyrë e përshtatshme për punë në terren.
- Qepje të përforcuara dhe rezistencë ndaj grisjes.

Kominoshe Pune

- Material i fortë dhe rezistent ndaj konsumit mekanik.
- Përbërje pambuk/poliester ose ekuivalent.
- Të jetë komode dhe e përshtatshme për lëvizje gjatë punës.
- Me xhepa anësorë dhe xhep funksional në pjesën e gjoksit.
- Qepje të përforcuara në pjesët me ngarkesë më të madhe.
- Rezistente ndaj larjeve të shpeshta.

Mushama Shiu

- Material kundër ujit dhe lagështirës.
- Me kapuç mbrojtës.
- Mbyllje me zinxhir ose kopsa hermetike.
- Të sigurojë mbrojtje nga reshjet dhe era.
- Material i lehtë dhe praktik për përdorim në terren.

Këpucë Pune

- Me mbrojtje në pjesën e përparme (kapak metalik ose material mbrojtës ekuivalent).
- Shollë kundër rrëshqitjes dhe rezistente ndaj konsumit.
- Rezistente ndaj lagështirës dhe kushteve atmosferike.
- Material i ajrosshëm dhe komod për përdorim të zgjatur.
- Të përmbushin standardet e sigurisë në punë.

Çizme

- Material gome ose PVC rezistent ndaj ujit dhe lagështirës.
- Shollë kundër rrëshqitjes.
- Rezistente ndaj konsumit dhe përdorimit në terrene të vështira.
- Të përshtatshme për punë në kushte me baltë dhe ujë.

Bluza Pune

- Material pambuku ose përzierje pambuk/poliester.
- Të rehatshme dhe rezistente ndaj larjes.
- Me mëngë të shkurtra ose të gjata sipas kërkesës.
- Ngjyra dhe modeli sipas identitetit institucional.

Doreza Pune

- Material mbrojtës ndaj konsumit mekanik.
- Të sigurojnë kapje dhe fleksibilitet gjatë punës.
- Të përshtatshme për përdorim në terren dhe punë manuale.
- Rezistente ndaj grisjes dhe konsumit.

Jelek Pune

- Material rezistent dhe i lehtë.
- Me elementë reflektues për siguri dhe dukshmëri.
- Me xhepa funksionalë.
- I përshtatshëm për përdorim në terren dhe gjatë punës në rrugë ose ambiente publike.

Kërkesa të Përgjithshme

- Artikujt duhet të dorëzohen sipas masave dhe numrave të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.
- Furnitori duhet të garantojë cilësinë dhe zëvendësimin e artikujve me defekte prodhimi.
- Të gjithë artikujt duhet të jenë në përputhje me standardet e sigurisë dhe higjienës në punë.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të cilësisë së mallrave në momentin e dorëzimit.
- Duhet të jenë të stampuara me logon “ Ndermarrja e Sherbimeve publike Bashkia Vlorë”

Argumentimi: *Specifikimet teknike janë hartuar nga autoriteti kontraktor për artikujt objekt prokurimi referuar nevojës reale,, duke përcaktuar informacionin minimal të nevojshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke u referuar për disa artikuj. Specifikimet teknike të përcaktuara në këto dokumente tenderi i përgjigjen nevojës së autoritetit kontraktor, çka nënkupton plotësimin e nevojave me cilësinë e kërkuar.*

Specifikimet teknike të përcaktuara për veshjet janë hartuar në funksion të garantimit të sigurisë, komoditetit, mbrojtjes dhe efikasitetit të punonjësve gjatë ushtrimit të detyrave funksionale në terren dhe në ambiente pune me kushte të ndryshme atmosferike dhe operative.

Përcaktimi i karakteristikave teknike është bërë duke respektuar kërkesat për cilësi, jetëgjatësi, rezistencë ndaj konsumit, si dhe standardet e sigurisë dhe higjienës në punë, me qëllim sigurimin e kushteve sa më të përshtatshme për punonjësit.

Specifikimet për xhaketën e punës janë përcaktuar për të garantuar mbrojtje ndaj lagështirës, konsumit dhe kushteve atmosferike gjatë punës në terren. Përbërja pambuk/poliester ose ekuivalente siguron kombinimin e komoditetit, ajrosjes dhe rezistencës mekanike. Elementët reflektues janë kërkuar për rritjen e dukshmërisë dhe sigurisë së punonjësve në ambientet e jashtme dhe gjatë punës në rrugë apo zona publike. Xhepat funksionalë dhe qepjet e përforcuara janë të nevojshme për praktikitet dhe jetëgjatësi në përdorim.

Kominoshet janë kërkuar me material rezistent ndaj konsumit mekanik dhe larjeve të shpeshta, pasi përdoren në procese pune me ngarkesë të lartë fizike dhe ekspozim të vazhdueshëm ndaj ndotjes dhe konsumit. Përforcimet në zonat me ngarkesë më të madhe garantojnë qëndrueshmëri dhe përdorim afatgjatë. Xhepat funksionale mundësojnë lehtësi në mbajtjen e veglave dhe pajisjeve të nevojshme gjatë procesit të punës.

Mushamat janë kërkuar me material kundër ujit dhe lagështirës për të garantuar mbrojtjen e punonjësve gjatë reshjeve dhe kushteve të pafavorshme atmosferike. Kapuçi mbrojtës dhe mbyllja hermetike sigurojnë izolim më të mirë nga uji dhe era, duke mundësuar vijimin normal të punës në terren edhe në kushte shiu.

Këpucët e punës janë specifikuar me mbrojtje në pjesën e përparme dhe me material rezistent ndaj konsumit, lagështirës dhe rrëshqitjes, me qëllim mbrojtjen e punonjësve nga dëmtimet fizike gjatë ushtrimit të detyrës. Materiali ajrosës dhe komoditeti janë kërkuar për përdorim të zgjatur gjatë orarit të punës. Kërkesa për përmbushjen e standardeve të sigurisë në punë është vendosur për garantimin e mbrojtjes minimale teknike dhe funksionale.

Çizmet janë kërkuar me material rezistent ndaj ujit dhe lagështirës për shkak të përdorimit të tyre në terrene me baltë, ujë dhe kushte të rënduara atmosferike. Sholla kundër rrëshqitjes dhe rezistenca ndaj konsumit janë të domosdoshme për sigurinë dhe qëndrueshmërinë gjatë përdorimit në terrene të vështira.

Bluzat e punës janë kërkuar me material pambuku ose përzierje pambuk/poliester për të siguruar rehati, ajrosje dhe rezistencë ndaj përdorimit dhe larjeve të shpeshta. Përcaktimi i modelit dhe ngjyrës sipas identitetit institucional synon paraqitjen uniforme dhe identifikimin e punonjësve të institucionit gjatë ushtrimit të detyrës.

Dorezat janë specifikuar me material mbrojtës dhe rezistent ndaj konsumit mekanik për të garantuar mbrojtjen e duarve gjatë proceseve të punës manuale dhe përdorimit të pajisjeve të ndryshme. Kërkesat për fleksibilitet dhe kapje të sigurt synojnë rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së punonjësve gjatë punës.

Jelekët e punës janë kërkuar me elementë reflektues për të garantuar dukshmëri dhe siguri gjatë punës në rrugë, ambiente publike apo zona me qarkullim. Materiali i lehtë dhe praktik siguron komoditet dhe lehtësi në përdorim gjatë gjithë orarit të punës.

Kërkesat e përgjithshme janë përcaktuar për të garantuar që artikujt e furnizuar të jenë në përputhje me standardet e cilësisë, sigurisë dhe higjienës në punë, si dhe për të siguruar që mallrat e dorëzuara të përmbushin kërkesat funksionale të Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për stampimin me logon “Ndermarrja e Sherbimeve Publike, Bashkia Vlorë” lidhet me identifikimin institucional dhe përdorimin zyrtar të veshjeve të punës.